



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **20.05.2021**, me fillim në ora **10.00**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private P – 71510068 – 02440 – Ratkoc;**
3. **Shqyrtimi i Draft rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës;**
4. **Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të vendimit 01 Nr.180/21, i datës: 29.03.2021 të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore;**
5. **Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të vendimit 01 Nr.181/21, i datës 29.03.2021 të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme;**
6. **Informatë nga DSHPS-ja rreth pandemisë Covid-19;**
7. **Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën janar – prill;**
8. **Të ndryshme.**

PIKAT SHITESË

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i plotësim ndryshimit të rregullores për vendosjen e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës se Rahovecit Nr. 2558, i datës:27.06.2014.**
2. **Vendim për formimin e komisionit vlerësues të objekteve për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës 01. Nr.189, të datës:29.04.2021.**
3. **Vendim për formimin e komisionit vlerësues të objekteve për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës 01. Nr.190, të datës:29.04.2021.**

4. **Vendim për formimin e komisionit vlerësues të objekteve për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës 01. Nr.191, të datës:29.04.2021.**
5. **Vendim për formimin e komisionit vlerësues të objekteve për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës 01. Nr.192, të datës:29.04.2021.**

Kryesuesi – Te nderuar kolegë kuvendarë, kemi edhe tri pika shtesë, e para ka të bëjë me plotësim ndryshimin e rregullores për vendosjen e objekteve të përkohshme. Kjo pikë shtesë lidhet me pikën e tretë të rregullt e cila është për dhënien në shfrytëzim më pak se një vit. Kurse te rregullorja deri më tani e kemi pasur në afatshkurtër 1-15 vite dhe afatgjatë që është. Dhe për këtë arsye duhet të futet edhe kjo pikë shtesë që të mundet të rregullohet kjo rregullore pasi aty duhet të hiqen disa nene. Pikë tjetër, pasi në mbledhjen e kaluar i kemi pasur 4 pika për dhënien në shfrytëzim, janë të kthyera mirë dhe janë të ligjshme mirëpo nga MAPL-ja kanë kërkuar që për secilën pronë që jepet në shfrytëzim mos të jetë i njëjti komision kryesues por brenda komisionit duhet të bëhet lëvizja apo ndërrimi i kryesuesit të atij komisioni për secilën pronë që jepet në shfrytëzim te jetë kryesues tjetër për brenda atij komisioni, që duhet të merren katër vendime për ndërrimin e emrave të komisionit, si dhe në planin e punës së kuvendit e kemi pasur informatën rreth qarkores së parë buxhetore në muajin maj mirëpo fatkeqësisht nga Ministria na ka ardhur shumë me vonesë, kështu që ndoshta do të ishte më mirë që në mbledhjen e qershorit ta kemi qarkoren e parë buxhetore. Kurse për këtë mbledhje tash në KPF apo edhe në mbledhjen e rregullt që do ta kemi do të jetë vetëm si informatë. Pra, kisha kërkuar si sqarim me bo për shkak të korrektësisë tani pasi në planin e punës në muajin maj e kemi pasur informatën që me na ardh mirëpo na ka ardh shumë me vonesë. Atëherë nëse ka dikush diçka rreth kësaj?

Rasim Fazliu – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetarin, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët dhe gjithë të pranishmit. Krejt në rregull siç e cekët ju për lëvizjet që duhet t'i bëjmë për shkak se ka kërkuar ashtu ministria përkatëse, mirëpo unë këtu po e shoh që në dy vendime shkruan Artan Asllani si kryesues. Por, siç duket nuk e kam vërejt mirë sepse qenka Artan Zenuni, kështu që ju kërkoj falje.

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të KPF-së, e qesim në votim rendin e ditës me pikat shtesë. Atëherë konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës me pikat shtesë. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush ndonjë vërejtje apo të shtojë dikush diçka rreth procesverbalit.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Kam një ndërhyrje të vogël që me siguri është gabim teknik, tek faqe 5 të fjalimi im që thotë faleminderit z.Cena, kështu që mendoj se do të duhej të ishte faleminderit kryesues, pra duhet të përmirësohet ky gabim.

Kryesues – Faleminderit z. Cena, atëherë meqë nuk ka tjerë të lajmëruar, e qesim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private P – 71510068 – 02440 – 0 Ratkoc;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtor te drejtorive, anëtarë te KPF-së dhe gjithë ju te pranishëm. Para jush keni propozimin e kryetarit te komunës për dhënien e pëlqimit për këmbim te pronës publike komunale me pronë private për interes publik. Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Ratkoc, kështu që ne jemi munduar me prezantua edhe në projektor që me pas mundësi me pa saktësisht se ku gjendet, e cila është në hyrje te fshatit Ratkoc, që bëhet fjalë për rrugën e cila është e asfaltuar prej vitit 1990 Gexhe –Ratkoc-Kramovik. Është marrë prona private në emër të Nysret Morina nga Ratkoci i cili është shfrytëzues i parcelës 1713-5,1713-6, 1713-4 dhe 1713-7 me sipërfaqe prej 5 ari e 9m2 për hapje te rrugës. I njëjti pronar te njëjtë që është marrë për rrugë që është rrugë e asfaltuar prej vitit 1990, i njëjti ka shfrytëzuar sipërfaqen përafërsisht te njëjtë në anën e majtë te rrugës ku është i ndërtuar edhe një objekt dy katëshe me sipërfaqe te njëjtë, por vetëm po kërkoj mirëkuptim prej juve se bëhet fjalë për propozim te njëjtë për këmbim prej 5 ari e 9m2. Ne kemi dal në vendin e ngjarjes dhe kemi incizuar gjendjen dhe kemi pae se ka

me pak sipërfaqe se 5 ari. Ne mbledhje te kuvendit e propozojmë propozimin, pra behet fjalë se ne i kemi marr pronarit 5 ari e 9m2 ndërsa po i japim 4 ari 86 m2, pasi aq është sipërfaqja e pronës publike që lejohet me u këmbeye atje, për arsye se ne kemi shtrua një rrugë me kubëza aty dhe nuk premtom sipërfaqja që te këmbehet një me një. Pra, rruga pronarit privat i ka marr 5 ari 9m2 ndërsa po i jepen 4 ari 86 m2. Kështu që ftoj anëtarët e KPF-së që pas shqyrtimit të aprovojnë propozim vendimin e kryetarit për dhënien e pëlqimit për këmbim e pronës publike me pronë private.

Fehmi Cena – Ne kemi kaluar fazën e parë dhe është shpallur interesi i përgjithshëm në njërin nga mbledhjet e kaluara dhe tash jemi në fazën e dytë që po kërkohet këmbimi i pronës së paluajtshme komunale me pronë private. Unë po mendoj se kjo është në rregull që kjo të kaloj edhe pse ndoshta në mbledhje të kuvendit mund të ketë dilema, pasi edhe me mbledhjen e kaluar dikush e dha një propozim që mos të kemi dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, por, ne tash si Komitet për Politikë dhe Financa më duket e arsyeshme që kjo të kalojë dhe të rrumbullakohet procesi pasi është kryer faza e parë dhe duhet të kryhet edhe faza e dytë, kështu që gjithçka është në rregull pasi është edhe rruge publike, kështu që duhet ta procedojmë për kuvend.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e dëgjova drejtorin me vëmendje, mirëpo, unë e kam analizuar dhe e shoh që nuk janë fjalët e drejtorit për atë çka e tha, pasi këtu shkruan se i jepen 509m2 dhe i merren 509m2 d.m.th. këmbimi bëhet i saktë 509 me 509 këtu në dokument. Kështu që e falënderoj drejtorin për sqarimin, por, fjalët e tij duhet të futen të regjistrohen dhe të përmirësohet për mbledhje të kuvendit që me ardh saktësisht ashtu siç tha drejtori sepse këtu shkruan se është e barabartë sepse tani mund të pasojë pyetja metrat tjerë katror a do të kompensohen, që sigurisht sipas ligjit kompensohen me para dhe bëhet vlerësimi i atyre metrave katror d.m.th. këtu është e barabartë i jepen 509 m2 dhe i merren 509 m2 prej pronës shoqërore komunale. Kështu që për mbledhje të kuvendit me sjellë të saktë ashtu siç tha drejtori, e jo fjalët ndryshe kurse ne dokument me qenë diçka tjetër ndryshe.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak se një vite të pronës së paluajtshme të Komunës;

Mirsad Shala – Përshëndetje i nderuari kryesues, nënkryetar, drejtor te drejtorive, anëtare te KPF-së dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Rregullorja për dhënien në shfrytëzim për me pak se një vit te pronës së komunës është rregullorja e cila e ka marr miratimin e kuvendit për dalje ne debat publik qysh disa muaj me herët pasi ka qenë ne debat publik dhe janë mbajtur disa konsultime online dhe ka qenë platformën e konsultimeve publike te qeverisë se Republikës se Kosovës dhe e njëjta i ka kalua te gjitha procedurat dhe tani na nevojitet vetëm aprovimi nga kuvendi i komunës. Kështu që pas shqyrtimit nga ana e juaj kjo rregullore mund të kalojë dhe të miratohet.

Fehmi Cena – Për hir të sqarimit, se z. Shala e sqaroi pasi është e vërtetë se në mbledhjen e muajit mars e kemi shqyrtuar këtë rregullore edhe kemi marr vendim që të kalojë në debat publik, pra, i paska kaluar ato procedurat mirëpo prapë këtë propozim që e kemi përpara po kërkohet që disa nene do të hiqen prej kësaj rregullore pra neni 10,11,12,13 i rregullores i cekur ne pikën 1 te këtij vendimi, propozimi do të largohen nga teksti bazik i kësaj rregulloreje. Pra, kërkujmë të na sqarohet për këtë se a është fjala nga kjo që e kemi shqyrtuar në kohë të fundit apo është kjo data lart në titull ku thotë 27.06.2014, kjo rregullore është shqyrtuar apo është vendosur ndonjëherë pasi është data 27.06.2014, pra këtu kërkoi sqarim.

Mirsad Shala – Faleminderit z. Cena, ajo çka folët ju është për plotësim ndryshimin e rregullores për vendosjen e objekteve të përkohshme në territorin e komunës së Rahovecit. Besoj që ne fillim kryesuesi e përmendi që ka qenë gabim teknik ne rend ditë që ju është dërguar juve mirëpo propozimi është për plotësim ndryshimin e rregullores për vendosjen e objekteve të përkohshme në territorin e komunës së Rahovecit, për shkak se neni 10,11,12, dhe 13 i kësaj rregulloreje do të jetë në kundërshtim me rregulloren për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës deri ne 1 vit, për shkak se këto 4 nene kanë të bëjnë pikërisht për këtë çështje d.m.th. dhënien në shfrytëzim të pronës të komunës. Kështu që, pasi që ne veç po e miratojmë një rregullore të re që është në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës deri ne 1 vit, këto nene janë në kundërshtim me këtë rregullore ndërsa nene tjera do te jenë në fuqi pasi që fliten për procedurat dhe kushtet që duhet te jepen për vendosjen e objekteve te përkohshme.

Fatmir Iska – Faleminderit kryesues, te nderuar anëtarë te KPF-së, drejtor dhe gjithë te pranishmit në sallë. Mendoj se është gabim teknik, kështu që ka pasur te drejtë doktori për shkak se propozimi i pikës së tretë e ka titullin për një rregullore kurse ne po diskutojmë për një rregullore tjetër dhe kjo është një gabim teknik dhe tash është me se qartë kjo, vetëm dola sa për sqarim rreth kësaj.

Rasim Fazliu – Zyrtari ligjor na informoj saktësisht se ju ka nënshtruar debateve publike dhe është diskutuar rreth kësaj rregulloreje, kështu që unë vetëm desha me pyet se prej datës kur e kemi pasur këtë draft rregullore ne shqyrtim edhe të gjitha trajtimet që janë bërë më tutje, a ka pasur ndonjë propozim tjetër apo ndryshim që ka ndodh karshi propozimit kur është dhënë në fillim. Cili është ndryshimi që është bërë apo kush ka propozua diçka tjetër kur ka qenë ne debat publik nëse ka mundësi me na plotësua apo nuk ka kurrfarë ndryshimi dhe ka mbet ashtu siç ka qenë propozimi, që kish pas mundësi me na dhanë sqarime rreth kësaj.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë. Siç e dini, janë futur edhe parkingjet për shkak se nuk kanë qenë ne draft rregulloren e mëhershme dhe janë eliminuar disa te tjera që kanë qenë në rregullore për shkak se janë disa pozicione, rregullorja për objekte te përkohshme e vjetra do te mbetet ne fuqi mirëpo janë hequr disa elemente për shkak ndryshimeve te reja që janë bërë ne ligje dhe udhëzimin administrativ për dhënien ne shfrytëzim për një vit. Këto janë disa elemente të vogla mirëpo ka pasur edhe propozime të reja ne këtë draft rregullore.

Kryesuesi – Faleminderit për sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë ne pikën e katërt te rendit te ditës:

4. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të vendimit 01 Nr.180/21, i datës 29.03.2021 të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore;

Kryesuesi – Të nderuar kolegë anëtare te KPF-së, na është kthyer për rishqyrtim nga MAPL-ja, për një procedurë si proces ligjor që duhet te vendos te ky vendim, që për me shume do të na sqaroj zyrtari ligjor.

Mirsad Shala – Faleminderit kryesues, te nderuar anëtarë të KPF-së, në mbledhjen e kaluar është marr një vendim për miratimin e planit lokal për menaxhimin e mbeturinave te ngurta. Mirëpo ministria e Planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës na ka dhënë një rekomandim që baza ligjore te shtohet neni 10,15 dhe 40 tek ligji për mbeturinat Nr. 04 L 060 dhe kanë kërkuar te deklarohet baza ligjore gjegjësisht neni 10,15 dhe 40 i ligjit për mbeturina nr 04 L 060 si dhe terminologjia e emërtimit te vendimit duhet te jetë konform dispozitave te këtij ligji, që do te thotë se ky vendim duhet te quhet miratimi i planit lokal për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore e jo siç e kemi shkruar ne nga mbeturinat e ngurta. Si dhe pika tjetër nëse me lejohet, edhe këtu kanë kërkuar vetëm te pjesa hyrëse e vendimit mungon deklarimi i bazës ligjore, pra neni 10 dhe 15 i ligjit për mbeturina, kurse te tjerat janë ne rregull, pra me tepër janë çështje teknike te baza ligjore.

Kryesuesi – Faleminderit për sqarimet z. Shala, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmërua sa i përket pikës së katër te rendit te ditës, atëherë kalon për kuvend pika e katërt e rendit te ditës. Kalojmë në pikën e pestë te rendit te ditës:

5. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të vendimit 01 Nr.181/21,i datës 29.03.2021 të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme;

Kryesuesi – Të nderuar kolegë, edhe kjo pikë sikur pika e katërt që e dha sqarimin z. Shala. Atëherë meqë nuk kemi diçka sa i takon pikës së pestë te rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e gjashtë te rendit te ditës:

6. Informatë nga DSHPS-ja rreth pandemisë Covid-19;

Samir Mustafa – Përshëndetje për të gjithë. Ju paraqes informatën rreth pandemisë, rreth situatës pandemike ne komunën e Rahovecit Covid-19. Nga fillimi i pandemisë deri më tani janë të paraqitura 1173 raste, ku raste te shëruara janë 1076, raste aktive janë 26, kurse me fatalitet janë 71, që gjithsej nga fillimi i pandemisë janë 1173 raste te paraqitura. Rasti i parë i paraqitur ne komunën e Rahovecit ka ndodhur me 24 prill 2020, ku dy infermieret nga komuna jonë që punojnë ne spitalin regjional te Prizrenit janë infektuar me Covid-19. Vazhdon dezinfektimi i institucioneve shëndetësore si QKMF, QMF, AMF ndërsa Reparti i Mjekësisë Familjare dhe Emergjencia dezinfektohen çdo ditë, për shkak të frekuentimit të madh të qytetarëve dhe pacientëve. Nga data 7 prill ka filluar edhe vaksinimi kundër Covid-19 në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, ku deri më tani numri i vaksinave të pranuar nga Ministria e Shëndetësisë janë 1832 doza të

pranuara, ku deri më sot janë vaksinuar 1425 qytetarë, ku 1233 qytetarë janë vaksinuar me vaksinën Astra Zeneca ndërsa 192 me vaksinën Pfizer. Aktualisht janë në dispozicion 540 doza të vaksinës Astra Zeneca ndërsa vaksina Pfizer nuk ka në dispozicion.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sjelljen e kësaj informate, shpresoj të shkon puna mirë sa i përket vaksinimit.

Fahrie Lushi - Faleminderit kryesues, të nderuar kolegë të Komitetit për Politike dhe Financa dhe gjithë të pranishmit në sallë. Së pari sa i përket informatës së sjellur nga kjo drejtori ka mjaftë gabime drejtshkrimi si p.sh. „maximalisht,, ndoshta të gjithë e lexojmë iksin si maksimalisht por në këtë rast në dokumente zyrtare nuk duhet të shënohet, pastaj stafi shëndetësor “kun je” dhe është dashur të shënohet ku një pjesë, pastaj të sëmuret “kornik” dhe duhet të jetë kronik, kështu që nuk lejohet këto gabime t’i tejkalojmë pasi që janë dokument zyrtar, pastaj “ministrisë” e që duhet te jetë ministrisë, pastaj në faqe tjetër ka edhe gabime tjera drejtshkrimore mirëpo është edhe diçka që është përmendur këtu dhe në fund të kësaj informate prapë gati se bije në kundërshtim me këtë, pasi në vitin 2020 me propozimin e kryetarit të komunës z. Smajl Latifi thuhet që është marr vendim që të ndahen mjete me vlerë financiare prej 10,000 euro. Pastaj drejtorja thekson se për vitin 2021 kuvendi nuk ka ndarë mjete ende mirëpo ajo që e përmenda në fillim dhe që bie në kundërshtim ku thuhet se si drejtori vazhdimisht jemi përballur me mungesë të materialit mbrojtës për personelin mjekësor duke filluar nga ato me elementare. Tash se çka është kjo në krahasim me vitin 2020 që janë ndarë 10,000 euro dhe ku shkuan ato që si drejtori vazhdimisht jeni ballafaquar me mungesë të atyre elementeve bazë.

Rasim Fazliu - Unë veç desha me pyet drejtorin, meqë nuk e ka cekur që për vitin 2021 ende nuk janë ndarë mjetet për menaxhimin e situatës, pasi për vitin 2020 i kemi ndarë 10,000 euro me kërkesën e kryetarit, kështu që dua të di se a janë shpenzuar ato 10,000 euro dhe a ka nevojë me nda mjete tjera tash për vitin 2021, pra, ndoshta drejtori e qartëson këtë se a janë harxhuar apo nuk janë harxhuar apo ka nevojë për mjete shtesë por ende nuk është bërë kërkesa apo propozimi për këtë.

Samir Mustafa – Në vitin 2020, kuvendi me propozimin e kryetarit ka ndarë 10,000 euro dhe kjo shumë nuk është shpenzuar për material shpenzues por janë shpenzuar për kompaninë ku komuna që ka kontraktuar për vlerësimin e dëmeve ekonomike gjate kohës së pandemisë. Për vitin 2021 komuna e Rahovecit ende nuk ka propozuar për ndarjen e shumës për menaxhimin e pandemisë dhe tash nuk kemi ndonjë problem rreth furnizimit me material mbrojtës për stafin shëndetësor dhe situatë është me e qetë pandemike dhe nëse ka nevojë sigurisht se ne do te propozojmë por aktualisht nuk ka nevojë. Kompaninë që e ka kontraktuar komuna e Rahovecit ne vitin 2020 për vlerësimin e dëmeve ekonomike, nga ai kod është paguar.

Afrim Limani – Të nderuar asamblistë, nga shuma e ndarë me vendimin e kryetarit dhe me aprovimin e juaj që e keni marrë, janë ndaje 10,000 euro mirëpo kjo pjesë prej 10,000 eurove nuk është shpenzuar mirëpo sasia e shpenzuar ka qenë mbi 2000 euro sepse trajtimi apo furnizimi për pandeminë kemi pasur fondacione te shumta nga institucionet e ndryshme, kështu që nuk kemi pasur nevojë me shpenzua atë shume. Siç e potencoj drejtori ato mjete realisht janë destinuat diku tjetër dhe ne kemi pasur problem edhe me i shpenzua ato mjete sepse qysh ne fillim te marrjes se vendimit kanë qenë te zotuar. Kështu që me një arsytim nga ana e jonë edhe me shkresa te ndryshme që ju kemi adresua Ministrisë se Financave kemi arrit me i sistemua ato mjete edhe mos me i lanë që me shkua ne suficite atëherë edhe kemi orientua aty siç e tha edhe drejtori se ka qenë një arsytim me bazë që me u krye ky proces. Kemi pasur donacione te shumta gjatë asaj periudhe edhe nuk kemi pasur nevojë me i shpenzua mjetet tona, po ashtu, i kemi dezinfektua krejt rrugët e komunës se Rahovecit dhe gjithashtu edhe shkollat dhe krejt këto kanë rrjedhë prej donacioneve.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor për sqarimet, atëherë, meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Informatë nga Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën e janar – prill;
Berat Duraku – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, kolegë drejtor dhe gjithë ju të pranishëm. Para jush keni informatën nga Drejtorja e Bujqësisë për periudhën janar - prill, e cila është e planifikuar në planin e punës së këtij kuvendi të komunës. Kur e kemi caktuar kohën e dhënies së kësaj informate, sigurisht se jemi bazuar edhe në planin e punës së Ministrisë së Bujqësisë me të cilën kemi lidhje vazhdimisht në procesin e aplikimit me subvencione që bëhen në

ministrinë e Bujqësisë. Ministria ka dështuar prej planit kështu që edhe ne kemi dështuar pasi jemi të varur direkt prej tyre. Ndoshta është deshtë të shtyhet kjo informatë për shkak se kryesisht fokusin e kemi të aplikimi i subvencioneve si komuna më e madhe në vend që kemi mbi 3000 fermerë dhe aty pasqyrohen të gjitha të dhënat e fermerëve që aplikojnë për të mbjellat e tyre dhe gjithashtu edhe për vlerat monetare që planifikojnë t'i marrin prej ministrisë. Materialin e kemi përpara secili, veç po dua t'iu them se aplikimi për subvencione nuk është kryer dhe nuk e dimë as ne se kur do të fillon faza e aplikimit, për shkak të ndryshimit të qeverisë nuk kemi asnjë komunikim me ministrinë e Bujqësisë dhe vazhdimisht ju kemi drejtuar zyrtarisht me e-mail dhe kemi kërkuar sqarime se kur do të hapet dhe gjithashtu edhe kur të paguhet pjesa e mbetur e subvencioneve për vitin 2020 dhe ende nuk kemi marr asnjë përgjigje rreth kësaj, kështu që për mbledhje të kuvendit do të elaborojmë për më shumë rreth këtyre.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e kam lexuar me vëmendje informatën dhe e falënderoj drejtorin për këtë informatë që na ka sjellë. Do të ishte mirë që drejtori gjegjësisht qeveria komunale me insistua vazhdimisht te Ministria deri sa të përgjigjen pasi edhe ashtu e kanë obligim të japin përgjigje, kështu që insistimi duhet me qenë permanent edhe bujqit duhet t'i marrin të gjithë pasi aty shkruan që edhe 600 kanë mbet pa i marr dhe do të ishte mirë që gjithsej 3000 sa janë të kompletohen sa i përket subvencionimit. Pastaj desha me bo një pyetje shtesë për drejtorin rreth ndërtimit të serave që i kemi me participim në kuadër të komunës, pasi ne kemi ndarë mjete edhe për vitin 2020 dhe gjithsesi edhe për vitin 2021. Kështu që desha me pyet drejtorin që të gjitha ato serra që kanë qenë të planifikuara për vitin 2020 a janë ndërtuar dhe a kanë përfunduar apo vazhdon ende ndërtimi i tyre që me vazhdua edhe për vitin 2021.

Fehmi Cena – E falënderojmë drejtorin për këtë informatë që na ka sjellë për këtë periudhë kohore, siç edhe e ceku shqetësimet me kryesore pasi edhe unë i kam këto shqetësime për shkak se preket ajo pjesa më e ndjeshme e komunës tonë pra fermerët, bujqit për vonesën e pagesës së fazës së dytë të këtyre subvencioneve pasi shume po vonohen dhe gjithashtu është dashur që të fillojnë subvencionet për vitin 2021 ndërsa ata nuk i kanë marr as subvencionet për vitin 2020, kështu që po shihet një jo seriozitet këtu, pastaj aplikimi është dashur të bëhet qysh me datën 15 shkurt pasi është edhe në raport ndërsa ne sot jemi me 20 maj dhe ende s'ka filluar aplikimi për vitin 2021. Kështu që mendoj se është shqetësuese dhe bujqit tanë kanë arsye të shqetësohen, kështu që kërkojmë në këtë drejtim të kryhet kjo punë. Po ashtu edhe unë pajtohem plotësisht me z. Fazliu, që drejtorja e Bujqësisë dhe komuna ne përgjithësi t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë e veta me i sensibilizua çështjen sa më shumë e jo vetëm me shkua me komunikua me Ministrinë e Bujqësisë me shkresa, që dhe ashtu nuk po përgjigjen, kështu që të shfrytëzohen edhe forma tjera edhe mjetet e informimit që me komunikua me shumë me bujq me shoqata të caktuara, që të bëhet sa më shumë zhurmë në këtë drejtim sepse kjo me të vërtetë është e pakuptimtë pasi vonesa është shumë e madhe. Te vaksinimi i geneve kemi thënë se për herë të parë është bërë me subvencionim të komunës edhe të kafshëve tjera, po me intereson me qentë endacak si qëndron puna, a merret dikush me qentë endacak?

Berat Duraku – Në pyetjen e parashtruar nga Rasim Fazliu, ne po përpjekje dhe është insistim i vazhdueshëm, që po ashtu ne rubrikën e lajmeve ditën e diel dhe jemi prononcuar në RTK dhe pikërisht këto shqetësime i kam cekur edhe aty dhe gjithashtu i kam njoftuar edhe disa bujq, që janë prononcua edhe e kanë shpreh shqetësimin pikërisht për marrjen e subvencioneve për vitin e kaluar. E kemi cekur numrin 600 dhe fatkeqësia është nuk e dimë edhe sakte pasi që nuk kemi qasje në softuerit në ministri, përveç mbi bazën e evidencave që e kemi mbajt e që bujqit adresën e pare e kanë komunën konkretisht drejtorin e bujqësisë. Kemi tentuar edhe burime tjera që me gjet edhe njerëz indirekt pasi që zyrtarisht nuk po marrim përgjigje. Për ndryshe për aplikimin e vitit 2021 ne jemi të gatshëm, pasi do të jenë në dispozicion të dy zyrat funksionale në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc dhe gjitha përgatitjet janë bërë si me staf ashtu edhe me logjistik dhe në momentin që ata i hapin thirrjet atëherë ne jemi të obliguar me ju përshtat atij afati edhe me krye. Pastaj, pyetja e parashtruar rreth serave, e kemi pae se janë formuar dy komisione për verifikimin e ndërtimit të serave që janë ndërtuar dhe ne vazhdimisht i kemi monitoruar por specifikisht për secilin fermer përfitues të cilit ju ka ndërtuar sera kemi mbajt edhe procesverbal edhe kemi dal me një raport, ku dikun 51% e serave për vitin 2020 dhe 2021 janë të ndërtuara që realisht edhe tani janë duke vazhduar ndërtimi i tyre dhe kemi dy operator ekonomik ku varësisht edhe prej kushteve klimatike që po mbretërojnë për shkak të reshjeve të mëdha nuk kanë mundur me u përfundua. Sa i përket qenve endacak, është një lëshim që nuk e

kam cekur ne këtë informatë, ne kemi pasur një kontratë edhe për trajtimin e qeneve endacak dhe ajo është drejt përfundimin kryesisht për komunën tonë afër 350 qenë janë trajtuar, jashtë kësaj kontrate që është vaksinimi i qeneve shtëpiak me pronar, bagëtime të imëta dhe bagëtime të trasha, kështu që janë duke u trajtuar edhe qenët endacak dhe kemi një operator që ne e monitorojmë, operatori është i komunës tonë, pasi nuk kemi të drejtë me i eliminua. Kështu që për mbledhje të kuvendit do ta plotësojë edhe këtë brenda informatës.

Rasim Fazliu – Nuk dua të replikoj mirëpo për çështje të informimit, a nuk shkon kjo që 2021 me përfundua dhe a kanë përparësi që ata fermerë që e kanë fitua të drejtën për ndërtimin e serave me participim, që me i krye ata njëherë edhe me thanë që ka përfundua viti 2020 dhe tash po e nisim për vitin 2021, pasi me herët e potencuat se kemi filluar edhe për vitin 2020 edhe për vitin 2021. Kështu që mendoj se duhet me u krye fillimisht te vitit 2020 e pastaj me fillua me ata për vitin 2021, pra do të ishte mirë me shkua kështu me rend.

Berat Duraku – Kontratën që e kemi të lidhur është për dy vite, ku 243 është numri i fermerëve përfitues të serave. Kur e kemi lidh kontratën i kemi ftuar fermerët që me krye pjesën e participimit në komunë dhe me nënshkrua një kontratë me komunën që është obligim. Kështu që varësisht neve si na kanë ardhë fermerët me bo participimin ashtu edhe e kemi dorëzua listën të operatori për me i ndërtua serat ne terrene. Tash nuk po dua me prejudikua se ka mundur me mbet një e shtatorit apo tetorit por ka pasur situata kur ka shkua operatori te fermeri, ka mundur edhe me pas pengesa gjatë rrugës apo edhe vendi s'ka qenë i përgatitur apo ka mundur me pas të mbjellë me diçka vendin ku u deshtë me ndërtua serën dhe ka kërkuar që ajo te ndërtohet me vonë, pra janë këto situata që kanë mundur me shkaktua edhe shtyrjen. Po ashtu kemi edhe 30% e fermerëve akoma nuk e kanë kryer participimin, për arsye se edhe ashtu participimi po kushton pasi që për 10 ari participimi kushton 1800 euro, kështu kemi edhe këso vështirësi mirëpo kemi afat me kontratë dhe procesi është duke vazhduar.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimet, atëherë të nderuar kolegë kuvendarë, meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, kalon për kuvend edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Tani kalojmë ne pikat shtesë dhe kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj ashtu siç i sqarova ne fillim të mbledhjes dhe tash janë si pika të rregullta për mbledhje të kuvendit.

PIKAT SHITESË

1. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të rregullores për vendosjen e objekteve te përkohshme në territorin e Komunës se Rahovecit 01 Nr.2558, i datës 27.06.2024;
2. Vendimi për formimin e komisionit vlerësues te ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme te komunës 01 Nr.189/21,i datës 29.04,2021;
3. Vendimi për formimin e komisionit vlerësues te ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme te komunës 01 Nr.190/21,i datës 29.04,2021;
4. Vendimi për formimin e komisionit vlerësues te ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme te komunës 01 Nr.191/21,i datës 29.04,2021;
5. Vendimi për formimin e komisionit vlerësues te ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme te komunës 01 Nr.192/21,i datës 29.04,2021;

Kryesuesi – Për secilën nga këto vendime, duhet te merret ndryshimi kurse për drejtorin e Financave z. Afrim Limani e ftojë që për mbledhjen e qershorit te jemi gati me qarkoren buxhetore kurse për këtë mbledhje nuk kemi nevojë rreth informatës. Të nderuar kolegë, anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, faleminderit për kontributin dhe mirëkuptimin tuaj.

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

